

MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: Bashkimi i operatorëve ekonomikë B.O.E - GJERGJEFI shpk + KLER shpk + TONI OIL shpk + D&E shpk me adresë: Njësia Bashkiake nr. 9, Lagjja nr.4, rruga “Ramazan Shijaku”, pallati i fimës Konuda Alfa nr.1, kati 1, magazinë, Tiranë.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur”

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-62051-04-11-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje konfeksione (veshje) për uniformen verore për Policinë e Shtetit”, me fond limit 190 253 400 (njëqind e nëntëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e katërqind) lekë pa TVSH.

Afatet e lëvrimit: 60 ditë nga lidhja e kontratës

Publikime të mëparshme *jo*: Buletini i Njoftimeve Publike *nr. 15 datë 24 Prill 2018*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik EKSPLO SISTEM me numër NIPT K01621001F nuk ka paraqitur ekonomike.
2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë B.O.E - GJERGJEFI shpk + KLER shpk + TONI OIL shpk + D&E shpk, me numër NIPT J66702620Q-J91803005H-K37006629S-K71804001C me ofertë ekonomike 164.200.000 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e dyqind mijë) Lekë pa TVSH.
3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë B.O.E- MALBERTEX-ARISA KONFKESION, me numër NIPT K71821009N-J61828068L, me ofertë ekonomike 178.534.780 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milion e pesëqind e tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e tetëdhjetë) Lekë pa TVSH.

4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë B.O.E - MARS&AL-SUMMER CONF SRL, me numër L21502014K-8145996 Kodi Unik Rumani me ofertë ekonomike 186.690.600 (njëqind e tetëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik EKSPLO SISTEM me numër NIPT K01621001F nuk ka paraqitur ekonomike. Ky operator ekonomik:

- *Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për kualifikim sipas DST.*

2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë B.O.E- MALBERTEX-ARISA KONFKESION, me numër NIPT K71821009N-J61828068L, me ofertë ekonomike 178.534.780 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milion e pesëqind e tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e tetëdhjetë) Lekë pa TVSH.

- 1) *Ofertuesi Bashkimi i Operatorëve Ekonomik (BOE) MALBERTEX shpk (5%) dhe ARISA shpk (95%), nuk arriti të plotësojë kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.1 “Kapaciteti teknik” të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim, sepse anëtari i BOE, ARISA shpk me përqindje të pjesëmarrjes 95%, nuk ka arritur të provojë realizimin e furnizime të mëparshme, të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën prej 40% të vlerës së fondit limit (72.296.292 Lekë), në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuar në akt marrëveshje. Sqarojmë se për furnizimet e ngjashme të realizuara me subjekte private, për periudhën 22.05.2015 – 22.05.2018, ka paraqitur fatura përkatëse tatimore të shitjes ku janë shënuar datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, në vlerën totale prej 46.771.687 Lekë, nga 72.296.292 lekë minimalisht të kërkuara. Po ashtu, ky kriter nuk përmbushet as nga i gjithë bashkimi i operatorëve ekonomik, sepse anëtari MALBERTEX shpk ka provuar realizimin e furnizime të mëparshme, të ngjashme, në vlerën 18.235.960 Lekë, dhe ARISA shpk ka provuar realizimin e furnizime të mëparshme, të ngjashme, në vlerën 46.771.687 Lekë, duke rezultuar në një vlerë të përgjithshme të furnizimeve të ngjashme prej 65.007.647 Lekë, nga 76.101.360 lekë minimalisht të kërkuara.*
- 2) *Ofertuesi Bashkimi i Operatorëve Ekonomik (BOE) MALBERTEX shpk (5%) dhe ARISA shpk (95%), nuk arriti të plotësojë kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim, sepse anëtari i BOE MALBERTEX shpk (5%) nuk arriti të provojë se disponon ambient të prodhimit, në pronësi apo në formë të tjera ligjore të posedimit. Ky operator ka paraqitur kontratën noteriale të qerasë me nr.1106 rep. nr.681kol. datë 28.09.2015, në nenin 3 të së cilës rezulton se afati i përfundimit është data 01.10.2016. Prandaj ofertuesi nuk arriti të provojë se në kohën e zhvillimit të procedurës disponon ambient ku do të zhvillojë aktivitetin e tij projektues dhe prodhues, me dokumentacionin përkatës të kërkuar në DT. Sqarojmë se në nenin 3 të kontratës noteriale të qirasë është parashikuar edhe drejta e rinovimit të kontratës, por nga ana e ofertuesit nuk është arritur të provohet me dokumentacion shkresor nëse kjo kontratë është rinovuar.*
- 3) *Ofertuesi Bashkimi i Operatorëve Ekonomik (BOE) MALBERTEX shpk dhe ARISA shpk, nuk arriti të paraqesë dokument të saktë, origjinal ose kopje të noterizuar, për të provuar përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.11 “Oferta Teknike” të Kriterëve të Vecanta*

për Kualifikim. Dokumenti i emërtuar "Pëlhurat_shqip", në versionin e skanuar të hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik, është i pallexueshëm përsa i përket faqeve, në dukje skeda teknike (referuar formatit dhe logos). Sqarojmë se këto dokumente të krijojnë dyshimin se janë skedat teknike të lëshuara nga prodhuesi Arikan, por përmbajtja e tyre është plotësisht e pallexueshme në elementët e detyrueshëm si: kontaktet (telefon, email, faqe interneti), NIPT-in, adresën, emër mbiemër, firmën e përfaqësuesit ligjor me vulën e kompanisë prodhuese të tekstili dhe të dhënat specifike të produkteve. Po ashtu, përmbushja e këtij kriteri nuk provohet të plotësohet me asnjë nga dokumentat e skanuar pjesë e ofertës elektronike. Bazuar në Manualin nr.02 datë 06.02.2018 "Për rolin e Administatorit të Sistemit të Autoritetit Kontrator, për rolin e Nëpunësit të autorizuar të Njësisë së Prokurimit dhe për rolin e Anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të ofertave, në Sistemin e Prokurimit Elektronik", pika 4.1 dhe Manualit Nr.01 datë 26.01.2018 "Për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronik", ngarkimi i dokumenteve në sistem është përgjegjësi e operatorit ekonomik dhe duhet të kryhet sipas udhëzimeve që APP ka publikuar lidhur me ngarkimin e dokumenteve dhe ruajtjen e tyre në Sistemin e Prokurimit Publik. Sa më sipër, rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti ose të dokumentave të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

- 4) Ofertuesi Bashkimi i Operatorëve Ekonomik (BOE) MALBERTEX shpk dhe ARISA shpk, nuk arriti të plotësojë kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.6 të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim, sepse anëtari i BOE, MALBERTEX shpk me përqindje të pjesëmarrjes 5% nuk arriti të paraqesë një certifikatë sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001:2015 (ose ekuivalente të vlefshme) të sistemit të menaxhimit të cilësisë sepse certifikata e paraqitur Nr.1710AL99Q është lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i pa akredituar për fushën e veprimtarisë sipas objektit të prokurimit (prodhim veshjesh), nga një organizëm kombëtar ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. Subjekti RIGCERT lëshues i certifikatës së paraqitur, nga verifikimet e kryera në zbatim të Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe DPA-së në fuqi nga data 20.03.2018, në organizmat akreditues nënshkrues të marrëveshjes së njohjes reciproke me EA, ILAC dhe IAF, nuk rezultoi i akredituar për ISO 9001: 2015 në fushën e veprimtarisë sipas objektit të prokurimit (prodhim veshjesh). Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 të VKM-914 datë 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes. Në rastin konkret anëtari i BOE, MALBERTEX shpk ka marrë përsipër prodhimin e disa artikujve, referuar kontratës së bashkëpunimit Nr1449 Rep, Nr.947Kol, datë 11.05.2018.
- 5) Ofertuesi Bashkimi i Operatorëve Ekonomik (BOE) MALBERTEX shpk dhe ARISA shpk, nuk arriti të plotësojë kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.9 të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim, sepse asnjë prej anëtarëve të BOE nuk ka paraqitur një deklaratë ose certifikatë nga prodhuesi i lëndëve të para që do të përdoren për prodhim për artikullin këmbësor me mëngë të shkurtra meshkuj/femra, për të provuar se materialet e përdorura nuk përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyrues.
- 6) Ofertuesi Bashkimi i Operatorëve Ekonomik (BOE) MALBERTEX shpk dhe ARISA shpk, nuk arriti të plotësojë kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.11 "Oferta Teknike" të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim, sepse dokumenti i emërtuar "Cope_kemishe_SERYILMAZ_POLY_PMK_80-20_COMPACT_A_MAVI-1" i paraqitur nga ofertuesi në gjuhën angleze dhe turke, nuk ka firmën e përfaqësuesit ligjor, vulën e kompanisë

prodhuese të tekstilit, si dhe nuk është i përkthyer e noterizuar në gjuhën shqipe sic kërkohet në DT, duke përbërë rast për skualifikim.

- 7) *Ofertuesi Bashkimi i Operatorëve Ekonomik (BOE) MALBERTEX shpk dhe ARISA shpk, nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.11 “Oferta Teknike” të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim ku janë kërkuar 2 (dy) modele fizike për çdo objekt të prokuruar, sepse nuk ka paraqitur 2 (dy) modele fizike Nr.41 për jakat e artikullit këmishë me mëngë të shkurtra meshkuj dhe 2 (dy) modele fizike Nr.42 për jakat e artikullit këmishë me mëngë të shkurtra femra, nga të cilat njëra duhet të jetë e qepur me fije sipas ngjyrës së objektit dhe tjetra me fije të kuqe, kërkesë kjo e përcaktuar tek Aneks Nr.1 (Specifikimet Teknike) pjesë e DT.”*

3. **Bashkimi i operatorëve ekonomikë B.O.E - MARSIAL-SUMMER CONF SRL, me numër L21502014K-8145996 Kodi Unik Rumani me ofertë ekonomike 186.690.600 (njëqind e tetëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH.**

- 1). *Ofertuesi Bashkimi i Operatorëve Ekonomik MARSIAL dhe Summer Conf s.r.l., nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.11 “Oferta Teknike” të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim, sepse nuk ka paraqitur skedë teknike dhe deklaratë vërtetësie nga laboratorit, për lëndën material reflektiv të kërkuar në Aneksin Nr.1 (Specifikimet Teknike) ku për artikujt që përmbajnë elementë reflektiv në listën e testimëve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtyre artikujve dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testimëve, përfshihet edhe testimi për standardin për shiritat reflektivë dhe veshjet për sigurinë në punë. Sqarojmë se skeda teknike plotësohet mbi bazën e karakteristikave dhe treguesve fiziko- mekanike e kimike të tekstilit të testuar. Kjo kërkesë është sqaruar edhe në Shtojcën Nr. 1 “Për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit, “Procedurë e hapur” me objekt “Blerje konfeksione (veshje) për uniformen verore për Policinë e Shtetit” ku sqarohet se: “Në lidhje me çështjen e treguesve fiziko-mekanik e kimik, bëjmë me dije se këta tregues kërkohen vetëm për materialin bazë, përveçse në rastet kur është specifikuar ndryshe, si p.sh., shiriti reflektiv.*

- 2) *Ofertuesi bashkimi i operatorëve ekonomik Marsi-Al dhe Summer Conf s.r.l., nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.11 “Oferta teknike” të kriterëve të vecanta për kualifikim, sepse nuk ka paraqitur modelet fizike në përputhje me Aneksin Nr.1 Specifikimet Teknike, pasi në mostrat e dorëzuara për artikujt bluzë me mëngë të shkurtra për femra dhe meshkuj, për punonjësit e policisë së rendit, bluzë me mëngë të shkurtra për femra dhe meshkuj, për punonjësit e njësisë speciale “shqiponja”, bluzë me mëngë të shkurtra për femra dhe meshkuj, për punonjësit e policisë rrugore, bluzë me mëngë të shkurtra për femra dhe meshkuj, për punonjësit e policisë së shtetit me shërbim pranë plazheve , bluzë me mëngë të shkurtra për femra dhe meshkuj, për punonjësit e policisë së shtetit, pantallona verore për meshkuj, për punonjësit e policisë së shtetit, pantallonat dhe fundi veror për femra, për punonjëset e policisë së shtetit, pantallona doku për forcat e ndërhyrjes së shpejtë , pantallona doku për femra dhe meshkuj në struktura të ndryshme të policisë së shtetit , pantallona të shkurtra për punonjësit e policisë së shtetit me shërbim pranë plazheve, kostumi taktik për femra dhe meshkuj, për punonjësit e policisë së shtetit, rezulton se mungojnë etiketat prej tekstili, në të cilat duhet të shkruhet ky informacion: emri i fabrikës, viti i prodhimit, përmasa, përbërja dhe instruksionet e mirëmbajtjes.*

- 3) *Ofertuesi bashkimi i operatorëve ekonomik Marsi-Al dhe Summer Conf s.r.l., nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.11 “oferta teknike” të kriterëve të vecanta për kualifikim,*

sepse në skedën teknike të lëndës së parë lëshuar në origjinal në gjuhën angleze nga prodhuesi Summer Conf srl për artikujt pantallona verore për meshkuj/femra dhe funde verore për femra, e dhëna teknike "thurja" është deklaruar diagonale 2/2 dhe "masa" është deklaruar 250 gr/m², ndërsa në dokumentin e përkthyer e noterizuar në gjuhën shqipe, rezultojnë që këto të dhëna shifra janë të ndryshme nga dokumenti origjinal. Konkretisht "thurja" deklarohet diagonale 2/1 dhe "masa" deklarohet 210 gr/m² ±3%. Në referim të Aneksit Nr.1 (Specifikimet Teknike) të dhënat e kërkuara për këtë lëndë të parë duhet të jenë "thurja" diagonal 2/1 dhe "masa" 210 gr/m² ±3%. Sa më sipër të dhënat teknike të lëndës së parë për artikujt pantallona verore për meshkuj/femra dhe funde verore për femra, nuk plotësojnë të dhënat teknike për thurjen dhe masën sic është kërkuar në DT.

- 4) Ofertuesi Bashkimi i Operatorëve Ekonomik Marsi-Al dhe Summer Conf s.r.l., nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.11 "Oferta Teknike" të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim ku janë kërkuar 2 (dy) modele fizike për çdo objekt të prokuruar, sepse nuk ka paraqitur 1 (një) palë pantallona doku të masës 44 për femra e qepur me fill blu të errët për njësinë speciale — Shqiponja, kërkesë kjo e përcaktuar tek Aneksi Nr.1 (Specifikimet Teknike) pjesë e DT. Sqarojmë se mungesa e kësaj mostre rezulton edhe nga procesverbali i dorëzimit të mostrave nga ofertuesit i datës 22.05.2018, në të cilin nuk rezulton të jetë evidentuar mostra për artikullin 1 (një) palë pantallona doku të masës 44 për femra e qepur me fill blu të errët për njësinë speciale — Shqiponja."

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë B.O.E - GJERGJEFI shpk + KLER shpk + TONI OIL shpk + D&E shpk, me numër NIPT J6670262OQ-J91803005H-K37006629S-K71804001C, me adresë: Njësia Bashkiake nr. 9, Lagjja nr.4, rruga "Ramazan Shijaku", pallati i fimës Konuda Alfa nr.1, kati 1 magazinë, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 164.200.000 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e dyqind mijë) Lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë autoritetit kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, menjëherë nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do të anulohet, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", (i ndryshuar).

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 11.06.2018

Ankesa: jo